



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 26.6.2023

Nr: 677

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 426 ID NGA Z. IVI KASO, NR. 437 ID
NGA Z. PREMTIM KRYEMADHI, NR. 418 ID, 420 ID, 430 ID 432 ID, NGA QENDRA
“QËNDRESA QYTETARE”, DHE NR. 443 ID, 445 ID NGA KOALICIONI PËR REFORMA,
INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA, NDAJ PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR
SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
14 MAJ 2023**

Sot më datë 26 Qershor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

KËRKUES: Z. Ivi Kaso, Sekretar për Çështje Ligjore
Z. Premtim Kryemadhi, Kandidat për Kryetar të Bashkisë Dibër
Zj. Albana Vokshi, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë
Qendra “Qëndresa Qytetare”
Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara

SUBJEKT: Z. Rakip Suli, Kryetar për bashkinë Kamëz
Zj. Floreta Faber, Ambasadore e Shqipërisë në SHBA
Z. Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr. 2, Bashkia Tiranë
Zj. Emiriana Sako, Kryetare për bashkinë Durrës
Z. Ilirjan Engjelli, Administrator i Njesisë Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë
Zj. Liri Qoshi, Administratore e Njesisë Administrative nr. 4, Bashkia Tiranë.
Zj. Alma Dervishaj, person përgjegjës për Ministrinë e Shendetesisë dhe Mbrojtjes
Sociale
Z. Rahim Spahiu, Kryetar dhe kandidat për bashkinë Dibër

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për postime, rispostime dhe përdorim hashtag në faqen e rrjetit social "Facebook"

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, neneve 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Janë administruar denoncime për të cilat pretendohet se institucione të ndryshme publike si dhe kryetar apo kandidatë për kryetar bashkie kanë postuar apo ripostuar në faqet e tyre personale publikime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të tyre, apo kanë bërë publikime me qëllim promovimin.

Subjektet e denoncuara janë si më poshtë vijon:

- 3 (tre) kryetar bashkie;
- 3 (tre) Njësi administrative në bashki;
- 1 (një) ministri;
- 1 (një) ambasador.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet portalit të denoncimeve si dhe në mënyrë shkrese.

Neni 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Data: 26.6.2023

Nr: 677
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 418 ID, 420 ID, 426 ID, 430 ID, 432 ID, 437 ID, 443 ID, 445 ID për shkelje administrative"

Në vijim të procedurës administrative, filloi shqyrtimi administrativ, duke verifikuar provat si dhe duke kërkuar informacion në lidhje me publikimet e postuara apo ripostimet me përmbajtje elektorale, slogane dhe # hashtag.

Denoncuesi ka paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

1. Denoncimet e regjistruar me nr. 395 ID, ndaj Z. Rakip Suli, Kandidat i Bashkisë Kamëz për publikimin në rrjetin social "Facebook" të 8 (tetë) veprimtarive për të cilat pretendohet si më poshtë vijon:

- Denoncim regjistruar me nr. **395 ID**, dërguar me shkresën nr. 179 prot., datë 5.5.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4697 prot., datë 5.5.2023, nga z. Ivi Kaso i cili pretendon se: *"Disa javë përpara zgjedhjeve vendore të 14 majit, kandidati i PS për bashkinë Kamëz njofton në rrjetin e tij FB si më poshtë:*

1. *Bashkë me Ministren e Arsimit Evis Kushi dhe Zëvendëskryeminstren Belinda Balluku kanë marrë pjesë në fillimin e punimeve për ndërtimin e shkollës "Hillary Clinton" në Kamëz;*
2. *Promovimi i punimeve të kryera në çerdhen "Dielli" në Kamëz;*
3. *Promovimi i projektit dhe punimeve në shkollën 9-vjeçare "Azem Hajdari";*
4. *Takimi me edukatorët dhe fëmijët e kopshtit "Luledielli";*
5. *Takim me nxënësit e gjimnazit "Ibrahim Rrugova" në aktivitetin sportiv Kupa rinore Sfida 2023;*
6. *Promovimi i punimeve në gjimnazin "Gramoz Palushi", shkollën 9-vjeçare "Fatos Lami".*
7. *Promovimi i rikonstruksionit të shkollës "Kamza e re" e cila është publikuar dhe në FB e kryetares së kuvendit Lindita Nikolla. Shkolla "Dom Nikoll Kaçorri"*
8. *Promovimin e programit "Shëndeti në shkollë", së bashku me Ministren e Shëndetësisë Ogerta Manastirliu, në shkollën "Dom Nikoll Kaçorri".*

Publikimet

1. <https://www.facebook.com/100044332874482/posts/pfbid029iM8q9PHzSëHkQ2iGSuvJ3UaabCgachPpacce4dvjhRT88zPLX4K8cHgdKxU6bDkl/?d=ë&mibextid=afzh1R>
2. <https://fb.ëatch/kdmCCqVasy/?mibextid=afzh1R>
3. <https://fb.ëatch/kdmbPcErsI/?mibextid=afzh1R>
4. <https://fb.ëatch/kdIYB3eS7M/?mibextid=afzh1R>
5. <https://fb.ëatch/kdIKKv9dfQ/?mibextid=afzh1R>
6. <https://fb.ëatch/kdIF5EtveV/?mibextid=afzh1R>
7. <https://www.facebook.com/100044332874482/posts/pfbidorjvnEJCofmKTicTv6e6iqraqj7RqMEFG8YUNhvrvdC58yxë90id=afzh1R>

Data: 26.6.2023

Nr: 677

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 418 ID, 420 ID, 426 ID, 430 ID, 432 ID, 437 ID, 443 ID, 445 ID për shkelje administrative”

8. <https://www.facebook.com/100044332874482/posts/pfbid02yxdzS6xZc3ScNvbBkqxJGCzAvqavztYZsPK4qyUECSTt6d4DjeydohXEIZZGdx9ol/?d=ë&mibextid=afzh1R>

Bashkisë Kamëz më datë 7.5.2023 i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, për denoncimin e regjistruar me nr. 395 ID, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 8.5.2023, ka sqaruar se: *“Nga ana jone është realizuar çdo detyrim ligjor për raportimin e veprimtarive në fjalë me karakter publik. Pretendimi nga denoncuesit mbi këto veprimtari është krejtësisht i paqëndrueshëm dhe i pabazuar ligjërisht, pasi citimet në pretendimet e tij janë të ndryshme në përmbajtje nga postimet në faqen e “facebook”. Në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së rezultojnë të raportuara të gjithë veprimtaritë që plotësojnë kriteret ligjore për tu konsideruar veprimtari me karakter publik.*

Theksojmë se: Bashkia Kamëz e ushtron veprimtarinë e saj në mbështetje e zbatim të legjislacionit rregullues, përfshirë këtu çdo akt ligjor e nënligjor në fuqi. Ju vëmë në dijeni se: Insitucioni ynë ka ndërmarrë të gjitha masat me qëllim zbatimin e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Lidhur me aktivitetin nr. 1, me pjesëmarrëse Ministrin e Arsimit zj. Evis Kushi i është kërkuar informacion Ministrisë nëpërmjet postës elektronike e cila sqaron se : *“Ky aktivitet u organizua nga bashkia Kamëz dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit ka qenë e ftuar. Aktiviteti ka qenë i hapur për publikun dhe median dhe mund të merrte pjesë kushdo.*

Ky aktivitet është raportuar edhe nga MAS në KQZ në datën 10.02.2023, për t’u zhvilluar në datën 15.02.2023, dhe është theksuar në raportim, se Ministria Evis Kushi është e ftuar në këtë aktivitet. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka pasqyruar në KQZ aktivitetet e zhvilluara nga ky institucion gjatë periudhës parazgjedhore duke respektuar Kodin Zgjedhor dhe aktet e tjera nënligjore.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por pati të përfaqësuar vetëm nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Përfaqësuesja e MAS në seancë sqaroi se: *“Referuar denoncimit me nr. 395 ID, ku pretendohet se në aktivitet e pasqyruara në rrjetin social nga kryetari i bashkisë Kamëz në datën 16.2.2023 paraqitet ministria e Arsimit dhe Sportit, Zj. Evis Kushi e cila ka marrë pjesë në ceremonin për nisjen e punimeve për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare “Hillary Clinton”, bashkia Kamëz. Sqarojmë se ky aktivitet lidhet me fillimin e punimeve për ndërtimin e shkollës “Hillary Clinton” Kamëz e shembur nga tërmeti, me grantet e qeverisë Gjermane.*

Ministria, zj. Evis Kushi ka qenë e ftuar sepse ka qenë një aktivitet i organizuar nga bashkia Kamëz. Gjithashtu ky aktivitet është raportuar nga personi përgjegjës i Ministri së Arsimit dhe Sportit në

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datë 10.02.2023 brënda afatit të përcaktuar dhe në këto kushtë kërkojmë pushimin e procedimit administrativ ndaj Ministris së Arsimit dhe Sportit.”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, vlerësojmë se:

Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave të administruara nga palët në proces, si dhe pasi u dëgjuan pretendimet e palëve, vlerësojmë se, referuar nenit 3, pika 1.1, i vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtarinë e ndaluara për tu promovuar, nuk gjendemi në kushtet e shkeljes administrative lidhur me këtë denoncim.

Marrëdhëniet personale apo postimet në llogaritë personale në facebook të kryetarit të bashkisë, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore sic janë liria për tu shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike. Publikimi i pamjeve të aktiviteteve të ndryshme ku ka patur edhe të ftuar nuk vërteton lidhjen ndërmjet shkeljes ligjore të pretenduar dhe publikimit.

Nga faktet e administruara si dhe nga denoncuesi nuk arriti të provohej se nëpërmjet këtyre postimeve është bërë mbështetje dhe promovim i projekteve dhe/ose të investimeve me fonde të vëna rishtazi në dipozicion.

Për sa më sipër në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjate procesit administrativ, rezulton se objekti për këto denoncime nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

2. Denoncimet regjistruara me nr. 418 ID, ndaj Zj. Floreta Faber, Ambasadore e Shqipërisë në SHBA, ku pretendohet si më poshtë vijon:

- **Denoncimi me kërkues Zj. Albana Vokshi** i ardhur nëpërmjet portalit të denoncimeve me nr. unik 12922, datë 30.4.2023: *“Në një postim të datës 29 prill 2023, në profilin e saj në Facebook, Ambasadorja e Shqipërisë në SHBA, znj. Floreta Luli-Faber shkruan: "Për të gjithë ata që nuk e besojnë se sa shumë bëjnë shkodranët për njëri-tjetrin! Benet Beci!"*
Poshtë këtij statusi, ajo shpërndan një video të Top Channel ku një nga personazhet e programit BigBrother shpreh publikisht mbështetjen e tij për kandidatin e Partisë Socialiste për Kryetar Bashkie të Shkodrës, z. Benet Beci.
Ligji për Shërbimin Diplomatik, neni 51, pika ç, e ndalon kreun e përfaqësive diplomatike të jetë anëtar dhe aktivist i një partie. Zonja Luli-Faber nuk është anëtare e drejtpërdrejtë e asnjë

partie, por statusi i saj për Benet Becin është një mbështetje e drejtpërdrejtë për këtë qëllim, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura bashkëlidhur. Si deputete e Kuvendit të Shqipërisë kërkoj: marrjen e masave të menjëherëshme përfshirë saksionet të parashikojnë dispozitat ligjore për kandidatin e Partisë Socialiste. Kjo është shkelje e Kodit të Etikës së Ambasadorit.”

- **Denoncimi me kërkues qendra “Qëndresa Qytetare”** i ardhur nëpërmjet adresës elektronike si dhe nëpërmjet portalit të denoncimeve me nr. unik 13810, datë 12.5.2023: Zj. Floreta Faber, në kundërshtim me nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe fjalinë e dytë, të pikës 1, të nenit 37 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe në kundërshtim të hapur dhe flagrant me nenet 4 dhe gërmën "c", të nenit 51 të ligjit nr. 23/2015 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", Znj. Faber ka mbajtur qëndrime publike politike në mbështetje të një kandidati të caktuar dhe ka përdorur funksionin e saj, si dhe asetet publike në mbështetje të kandidatit të PS për Bashkinë Tiranë.

Më datë 18.5.2023, Ministrisë për Punët e Jashtme dhe Evropën i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike. Në vijim institucioni ka përcjellë në adresën elektronike pergjigjen e ambasadores zj. Floreta Faber ku bën me dije se: “Në email aludohet se kam mbajtur qëndrime publike politike në mbështetje të një kandidati të caktuar dhe kam përdorur funksionet e mia dhe asetet publike në mbështetje të kandidatit të PS për Bashkinë Tiranë. Për këtë është cituar nenin 91, i Kodit Zgjedhor.

Sic e dini, në faqen e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka një faqe për ambasadat, ambasadorët dhe mediat publike të cilat ato përdorin, të cilat janë asetet publike. Deklaroj me përgjegjësi të plotë dhe absolute që në asnjërin nga këto media, në asnjë moment të caktuar nuk ka patur mbështetje për asnjë kandidat të asnjë partie politike, apo te jetë përdorur ndonjë hashtag i partive politike.

Faqe Floreta Luli-Faber ne FB është faqe private.

Për pikën: fjalinë e dytë, të pikës 1, të nenit 37 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" Sqaroj se unë nuk jam subjekt i ligjit për "Nëpunësit Civil"... si dhe në kundërshtim të hapur dhe flagrant me nenet 4 dhe gërmën "c", të nenit 51 të ligjit nr. 23/2015 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë".

Ky nen thotë: punonjësi ka për detyrim: te mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës dhe, kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave dhe të vendimeve që zbaton, të njoftojë nivelet urdhërdhënëse dhe nivelet eprore të këtyre të fundit; Nuk e gjej dot lidhjen me këtë nen!

Data: 26.6.2023

Nr: 677
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 418 ID, 420 ID, 426 ID, 430 ID, 432 ID, 437 ID, 443 ID, 445 ID për shkelje administrative”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre,

Pas verifikimit të kryer, u vlerësua se postimet në llogaritë personale në facebook nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të burimeve publike, në këtë rast të postit publik.

Theksohet se legjislacioni në fuqi, referuar këtu ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk parashikojnë asnjë parashikim ligjor të shprehur mbi administrimin e mediave sociale personale nga ana e funksionarëve publik. Për rrjedhojë është e pamundur, në referim të këtyre postimeve, diferencimi i personit, individit në cilësinë personale, nga cilësia e funksionarit publik.

Në kushtet kur nuk është e qartë apo e rregulluar shprehimisht nga ligji kufiri i përdorimit të këtyre mjeteve të komunikimit, pretendimet e palës denoncuese janë të pabazuara dhe jo të përlligjura. Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve interferon në liritë themelore siç janë liria për tu shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike.

Në cdo rast tjetër, në kushtet ku objekt i shqyrtimit janë postimet nga llogaritë zyrtare në mediat sociale të institucioneve publike, postimet mund të shërbejnë si indicie për hetim, por gjithmonë në rast se ka mjaftueshëm të dhëna se veprimtaria publike është shfrytëzuar për thirrje elektorale.

Për sa më sipër, të ndodhur në kushtet ku referuar provave dhe fakteve mbi denoncimin nuk gjendemi para shkeljes administrative të legjislacionit në fuqi, për pasojë vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ ndaj zj. Floreta Faber.

3. Denoncimet regjistruara me nr. 432 ID, me kërkues qendra “Qëndresa Qytetare” ku pretendohet si më poshtë vijon:

- **Denoncim nr 432 ID ndaj Z. Erion Veliaj kryetar i bashkisë Tiranë dhe kandidat si dhe Njesisë Administrative Nr. 2**, i ardhur shkreserisht nga qendra “Qëndresa Qytetare”, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga ana jonë me nr. 5040 prot., datë 12.5.2023, si më poshtë: *“Paraqesim para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, këtë kallëzim kundër Z. Erion Veliaj dhe çdo personi tjetër, që gjatë hetimit administrativ do të rezultojë se ka përgjegjësi, për arsyet si më poshtë vijon:*

Në data të ndryshme, në faqen zyrtare të Njesisë Administrative nr. 2 janë postuar në rrjetin social Facebook, postime me përmbajtje qartësisht elektorale të kandidatit Erion Veliaj dhe

subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë". Në këto postime, vihet re përdorimi i sloganeve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, thirrje për mbështetjen e Erion Veliajt, si dhe shpërndarje të aktivitetit politik të këtij të fundit"

Më datë 16.5.2023, është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 23.5.2023 Njësia Administrative nr. 2, bën me dije se: *"Në faqen e vetme zyrtare të facebook Njësia Administrative nr.2 Tiranë, nuk gjendet asnjë postim me përmbajtje elektorale, të cilat vijnë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Kjo faqe përdoret vetëm për promovimin e punëve të përditshme të Njesisë Administrative nr. 2.*

Nëse ekzistojnë faqe të tjera të cilat mbajnë emrin e Njesisë Administrative nr. 2 dhe bëjnë postime elektorale, do t'ju luteshim të na vini në dijeni edhe ne, në mënyrë që të parandalojmë përdorues të cilet nuk kanë lidhje me Njesisë tonë e për të cilët ne nuk mund të mbajmë përgjegjësi."

Referuar nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se ***nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve publike***, denoncuesi pretendon se postimi i materialit me përmbajtje elektorale në faqen zyrtare facebook të institucionit publik, përbën përdorim të burimeve publike.

Megjithatë, të ndodhur në kushtet që në momentin e administrimit të denoncimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk arriti të vërtetojë nëse llogaria në "Facebook" objekt denoncimi administrohet nga administrata e Njesisë Administrative nr. 2, Tiranë dhe është një burim zyrtar i saj, si dhe ka mundur të sigurojë provën sa i përket postimeve në faqen Njësia Administrative nr.2 Tiranë referuar materialeve foto të administruara.

Në kushtet ku nuk u arrit të provohej nëse llogaria në "Facebook" objekt denoncimi i përket dhe administrohet nga Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, por nisur edhe nga fakti se administratori mohon ekzistencën e saj dhe pranon se në faqen e vetme zyrtare nuk gjendet asnjë postim, siç rezulton edhe nga hetimi administrativ, vlerësohet se nuk u bë i mundur konstatimi i shkeljes administrative.

Për sa më sipër, referuar provave dhe fakteve të administruara, vlerësohet se nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe duhet pushohet shqyrtimi administrativ për z. Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr. 2, Bashkia Tiranë.

4. Denoncimet regjistruara me nr. 393 ID, 420 ID, 430 ID, 445 ID, ku pretendohet si më poshtë vijon:

Data: 26.6.2023

Nr: 677

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 418 ID, 420 ID, 426 ID, 430 ID, 432 ID, 437 ID, 443 ID, 445 ID për shkelje administrative"

- **Denoncimi nr. 393 ID, ndaj Zj. Emiriana Sako kryetar dhe kandidat i bashkisë Durrës**, i ardhur shkreserisht nga qendra “Qëndresa Qytetare”, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga ana jonë me nr. 4609 prot., datë 4.5.2023, si më poshtë: *“Më datë 11 prill 2023, subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" çeli fushatën për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023. Në këtë aktivitet, e pranishme, ishte zj. Ermirana Sako, kryetare e bashkisë Durrës dhe njëherazi kandidate e subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë.”*

Pjesëmarrja e zj. Sako është pasqyruar dhe në rrjetet sociale të saj. Siç rezulton, ky postim, qartazi me natyrë politike, që promovon dhe mbështet kandidat te caktuar, është shpërndarë dhe nga faqja zyrtare e Bashkisë Durrës në rrjetet sociale.”

Më datë 7.5.2023 bashkisë Durrës i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe bashkia Durrës ka sqaruar se *“Aktiviteti i sipërcituar është publikuar në faqen zyrtare të kryeministrit, ndërkohë, gabimisht disa nga fotot e këtij aktiviteti janë shpërndarë edhe në faqen zyrtare të facebook-ut të bashkisë Durrës, nga përdoruesit e tij. Duke e konsideruar një lapsus shpërndarjen e tyre, nga administratori janë marrë menjëherë masat për heqjen e tyre.*

Sqarojmë edhe një herë se ky aktivitet nuk është pasqyruar nga znj. Emiriana Sako, por vetëm janë shpërndarë fotot e tij nga përdoruesit e faqes zyrtare të facebook-ut të bashkisë Durrës. Gjithashtu mund të shihet qartë dhe sot që në faqen zyrtare të facebook-ut të bashkisë Durrës nuk është publikuar asnjë aktivitet me karakter politik.

Duke dashur të kemi qenë të saktë në sqarimet tona lidhur me rastin në fjalë, kërkojmë mirëkuptimin tuaj për mosmarrjen e sanksioneve administrative ndaj znj. Emiriana Sako dhe ndaj çdo personi tjetër përgjegjës, vetëm për shkak të një lapsusi.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin me **nr. 393 ID**, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë u paraqit përfaqësuesi i bashkisë Durrës, i cili gjatë seancës deklaroi se: *“Është e vërtetë, diçka e till ka ndodhur. Është gabim njerëzor dhe janë marrë masat nga drejtori i kabinetit. Janë urdhëruar heqjet e fotove dhe që nga ai moment e mbrapa nuk ka pasur asnjë foto dhe asnjë publikim të kësaj natyre që shkel dispozitat ligjore. Duam të kërkojmë ndjesë për incidentin. Nuk janë hedhur nga faqja e bashkisë Durrës, por janë shpërndarje nga faqja e kryeministrit tek faqja e bashkisë. Nuk janë më, pasi janë hequr që nga momenti që është konstatuar.”*

- **Denoncimi nr. 420 ID, ndaj Z. Erion Veliaj kryetar i bashkisë Tiranë dhe kandidat si dhe Njesisë Administrative Nr. 11**, i ardhur shkreserisht nga qendra “Qëndresa Qytetare”, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga ana jonë me nr. 5036 prot., datë 12.5.2023, si më poshtë: *“Në faqen zyrtare të Njesisë Administrative nr. 11 janë postuar në rrjetin social Facebook, postime me përmbajtje qartësisht elektorale të kandidatit Erion Veliaj dhe subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë". Në këto postime, vihet re përdorimi i slloganeve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, thirrje për mbështetjen e Erion Veliajt, si dhe shpërndarje të aktivitetit politik të këtij të fundit”*.

Më datë 16.5.2023, është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 22.5.2023 Njësia Administrative nr. 11, bën me dije se: *“Njësia Administrative nr. 11 sapo është njoftuar për rastin në fjalë ka marrë masa të menjëhershme për fshirjen e postimit.*

Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se postimi është një lapsus, gabim njerëzor i bërë pa qëllim propagandistik, i cili nuk do të ndodhë më në zgjedhjet e ardhshme.

Duke ju kërkuar ndjesë, shpresojmë në mirëkuptimin tuaj!

- **Denoncim nr. 430 ID ndaj Z. Erion Veliaj kryetar i bashkisë Tiranë dhe kandidat si dhe Njesisë Administrative Nr. 4**, i ardhur shkreserisht nga qendra “Qëndresa Qytetare”, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga ana jonë me nr. 5399 prot., datë 12.5.2023, si më poshtë: *“Paraqesim para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, këtë kallëzim kundër Z. Erion Veliaj dhe çdo personi tjetër, që gjatë hetimit administrativ do të rezultojë se ka përgjegjësi, për arsyet si më poshtë vijon:*

Në data të ndryshme, në faqen zyrtare të Njesisë Administrative nr. 4, janë postuar në rrjetin social Facebook, postime me përmbajtje qartësisht elektorale të kandidatit Erion Veliaj dhe subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë". Në këto postime, vihet re përdorimi i slloganeve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, thirrje për mbështetjen e Erion Veliajt, si dhe shpërndarje të aktivitetit politik të këtij të fundit”

Më datë 16.5.2023, është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe Njësia Administrative nr. 4, bën me dije se: *“Njësia Administrative nr.4, ka qenë shumë korrekte lidhur me postimet e shpërndara në faqen e Facebook, të cilat përfshijnë vetëm ato postime të cilat pasqyrojnë punët e kryera në njësi. Lidhur me postimet në dy data siç ju përmendni në email, përkatësisht: -për datën 2.5.2023 ju bëjmë me dije se nuk është shpërndarë asnjë postim në faqen e Njesisë Administrative nr. 4.*

-për datën 25.4.2023 është shpërndarë postimi i cili përfshin vizitën e kryer nga kryetari i bashkisë në Njesinë 4, për të cilën ju kërkojmë ndjesë pasi nuk është shpërndarë për asnjë qëllim përvec se prezencës së tij në territorin e Njesisë nr. 4.

Data: 26.6.2023

Nr: 677

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 418 ID, 420 ID, 426 ID, 430 ID, 432 ID, 437 ID, 443 ID, 445 ID për shkelje administrative”

- **Denoncimi nr. 445 ID** i ardhur nëpërmjet raportiti XVII të KRIIK për periudhen 4 - 14 Maj 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve, nga KRIIK, si vijon: *“Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në postimet e kryera në faqen zyrtare të ministrise ka përdorur slogane ose hashtag që lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejt Subjektin Zgjedhor “Partia Socialiste”.*

Duke u vendosur, përdorur dhe reklamuar nga institucionet publike dhe drejtuesit e tyre në faqet zyrtare në Facebook, në gjykimin e KRIIK kemi të bëjmë me shpërdorim të autoritetit shtetëror, si dhe përdorim:

- të një asemi institucional (specifikisht të Faqes Zyrtare të Institucionit në mediat sociale, e cila përdoret gjerësisht si kanal komunikimi publik);
- të kohës së nëpunësve shtetërorë (personat e ngarkuar me mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e njoftimeve në këto faqe);
- si dhe të gjithë burimeve të tjera të vëna në dispozicion për realizimin e aktivitetit institucional, të cilave iu jepet valencë politike dhe iu atashohet në mënyrë të padrejtë një meritë partiake në funksion të një partie politike, çka është në kundërshtim me kuadrin ligjor zgjedhor, si dhe të parimit për ndarjen e shtetit nga partia.

Konkretisht:

“Firmosëm kontratat me mjekët e rinj specialistë, të cilët nisin rrugëtimin 4-vjeçar të specializimit në Mjekësi, të mbështetur nga pagat e rritura dhe në kushte dinjitoze në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si një garanci më shumë për formimin e duhur të mjekëve specialistë.

118 mjekë specialistë nënshkruan kontratën me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të shërbyer për 3 vite në përfundim të specializimit afatgjatë aty ku janë nevojat e vendit për mjekë të specializuar.

#MjekëPërShqipërinë #MëeMiraËshtëPërpara”

Prova

<https://www.facebook.com/MinistriaeShendetesisedheMbrojtjesSociale/posts/pfbid02XFchhE2s3Y9K1Gu7QQgopK4tGXq6cZNRyS6VhedF1C8E7pqEB8bhL8EQzrppb76ql>

Më datë 18.5.2023, është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bën me dije se: *“Në lidhje me rastin e sjellë në vëmendje, ju informojmë se ky është një rast sporadik, një gabim njerëzor ku është përmendur shprehje që mund të lidhet dhe identifikohet me një subjekt zgjedhor.*

Data: 26.6.2023

Nr: 677

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 418 ID, 420 ID, 426 ID, 430 ID, 432 ID, 437 ID, 443 ID, 445 ID për shkelje administrative”

Sapo u evidentua që ky postim ishte bërë ne faqen zyrtare të institucionit, postim i cili mund të krijojë dyshime për identifikim me sloganet e një subjekti zgjedhor, u morën masa të menjëherëshme për rregullimin e këtij postimi në përputhje me legjislacionin zgjedhor në fuqi për të shmangur cdo keqkuptim të mundshëm.

Ju lutem gjeni më poshtë link-un e postimit të rregulluar...”

Në përfundim të hetimit administrative mër denoncimet nr 393 ID, 420 ID, 430 ID, 445 ID, vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se *nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve publike*, denoncuesi pretendon se ripostimi i materialit me përmbajtje elektorale në faqen zyrtare facebook të institucionit publik, përbën përdorim të burimeve publike.

Përgjatë periudhës së shqyrtimit administrativ të denoncimeve të ardhura për shkelje administrative në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, janë evidentuar disa raste të përdorimit të burimeve publike në mënyrë indirekte nëpërmjet postimit apo ripostimit të materialeve me përmbajtje elektorale nga bashki dhe institucione publike. Pas vlerësimit objektiv të rrethanave dhe fakteve lidhur me këto denoncime është vendosur sanksionimi i subjekteve rast pas rasti.

Çfarë është e rëndësishme të theksohet është se legjislatori nëpërmjet sanksionit nuk ka për qëllim vetëm të ndëshkojë subjektin, por edhe të sigurojë që të tjerët të mos kryejnë veprime të paligjshme. Prandaj, sanksionet janë pjesë e sistemit ligjor për të ruajtur rendin shoqëror dhe për të promovuar drejtësinë në një shoqëri demokratike. Sanksionet shërbejnë si mjet për të korigjuar sjelljen e individëve dhe për t'i ndihmuar ata të mësojnë nga gabimet e tyre dhe të ndryshojnë sjelljen e tyre në të ardhmen.

Të ndodhur në kushtet që në momentin e administrimit të denoncimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk arriti të sigurojë provën objekt shqyrtimi, pasi është fshirë menjëherë nga subjektet e denoncuar, si dhe duke marrë parasysh faktin që postimi ka ndodhur për shkak të një gabimi njerëzor. Fakti që tashmë thuhet është kuptuar nga të gjithë institucionet që nuk mundet në faqet e tyre të internetit apo në profilet e tyre zyrtare të rrjeteve sociale të publikojnë aktivitete elektorale përfshirë këtu edhe të kryeministrit, vlerësohet se është e mjaftueshme për ta konsideruar këtë çështje të mbyllur dhe për të mos vendosur sanksion administrative për sa kohë që është korigjuar gabimi.

Nga sa u parashtrua më sipër, por edhe nga deklaratimet e palëve, evidentohet se institucionet publike kanë reaguar në mënyrë të menjëhershme duke vetë-rregulluar pasojat e mundshme

të ardhura nga postimi dhe për rrjedhojë vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ ndaj zj. Emiriana Sako, kandidate dhe kryetare e bashkisë Durrës, z. Ilirjan Engjelli, Administrator i Njesisë Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë dhe zj. Liri Qoshi Administratore e Njesisë Administrative nr. 4, Bashkia Tiranë.

Për sa më sipër në mbështetje të fakteve të administruara gjatë shqyrtimit administrative, rezultoi se për rastet objekt denoncimi, regjistruar me nr. 393 ID, 420 ID, 430 ID, 445 ID, vlerësohet se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe duhet t'i tërhiqet vëmendja përsoneve përgjegjës në mënyrë që të tregohet kujdes në publikimin e postimeve të ndryshme që përmbajnë slogane apo hashtag # me përmbajtje elektorale.

5. Denoncimi regjistruar me nr. 426 ID, 437 ID dhe 443 ID, ndaj bashkisë Dibër, ku pretendohet si më poshtë vijon:

- **Denoncimi nr. 426 ID** i ardhur shkreserisht me shkresen nr. 196 prot., datë 11.5.2023 i administruar me nr. 5055 prot, date 12.5.2023, nga z. Ivi Kaso, si vijon: *“Në faqen zyrtare të Bashkisë Dibër, në rrjetin social "FB" janë publikuar postime të drejtueses politike znj. Belinda Balluku së bashku me "hashtag" ku u kryen veprimtaritë elektorale nga kjo e fundit, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore si më lart.*

Postimet janë të datës 8.5.2023, ripostim i aktivitetit te postuar ne faqen e e zj. Belinda Balluku, ku shkruhet:

Dibra n'fest

#VetemPerpara #KurremeMbrapa; #krenareperps.”

- **Denoncimi nr. 437 ID**, i ardhur nëpërmjet portalit të denoncimeve me nr. unik 13626, datë 10.5.2023, nga z. Premtim Kryemadhi si vijon: *"Dua të denoncoj perdorimin e faqes zyrtare te bashkisë dibër në facebook: Bashkia Dibër faqja zyrtare për qëllime elektorale. Në këtë faqe, me datë 8.5.2023, në faqen zyrtare të bashkisë Dibër, në rrjetin social facebook, janë publikuar postime të drejtuesve politik zj. Balluku së bashku me hashtag ku u kryen veprimtaritë elektorale nga kjo e fundit."*

- **Denoncimi nr. 443 ID** i ardhur nëpërmjet raportit XVII të KRIIK për periudhen 4 - 14 Maj 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve, nga KRIIK si vijon: *“Bashkia Dibër në postimet e kryera në faqen zyrtare të bashkisë ka përdorur slogane ose hashtag që lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejt subjektin zgjedhor “Partia Socialiste”.*

Duke u vendosur, përdorur dhe reklamuar nga institucionet publike dhe drejtuesit e tyre në faqet zyrtare në Facebook, në gjykimin e KRIIK kemi të bëjmë me shpërdorim të autoritetit shtetëror, si dhe përdorim:

- të një asemi institucional (specifikisht të faqes zyrtare të institucionit në mediat sociale, e cila përdoret gjerësisht si kanal komunikimi publik);
- të kohës së nëpunësve shtetërorë (personat e ngarkuar me mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e njoftimeve në këto faqe);
- si dhe të gjithë burimeve të tjera të vëna në dispozicion për realizimin e aktivitetit institucional, të cilave iu jepet valencë politike dhe iu atashohet në mënyrë të padrejtë një meritë partiake në funksion të një partie politike, çka është në kundërshtim me kuadrin ligjor zgjedhor, si dhe të parimit për ndarjen e shtetit nga partia.

Konkretisht:

"DIBRA N'FEST e gjallëroi me aktivitetet e larmishme dhe e tejmbushi bulevardin "Elez Isufi" si asnjëherë më parë!

Promovimi ashtu siç #Dibra e meriton, sapo ka nisur..." #VetëmPërpara

Prova link:

<https://www.facebook.com/BashkiaDiber1/posts/pfbid035z7këAhsysKLRK6EQëTU5moeKLoUA7v9znjDhTëpH5xxrBUr8heSpD4tCA532J69/>

Më datë 16.5.2023, është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe bashkia Dibër, bën me dije se: "Lidhur me denoncimin ndaj Bashkisë Dibër nga KRIIK Albania ku pretendohet se bashkia Dibër ka përdorur faqen zyrtare ka përdorur slogane/hashtag për subjektin zgjedhor Partia Socialiste po ju informojmë se në faqen zyrtare të bashkisë Dibër nuk ka asnjë postim për të mbështetur subjektin zgjedhor "Partia Socialiste"

Në përfundim të shqyrtimit administrativ për denoncimet e regjistruara me nr. **426 ID, 437 ID, 443 ID** vlerësohet se:

Kodi Zgjedhor në nenin 91, pika 1 parashikon se "Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia". Po ky nen parashikon se "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.**

Data: 26.6.2023

Nr: 677

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 418 ID, 420 ID, 426 ID, 430 ID, 432 ID, 437 ID, 443 ID, 445 ID për shkelje administrative"

Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në “facebook” apo çdo mjeti tjetër komunikimi elektronik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve apo nëpërmjet ripostimit të postimeve të cilat përmbajnë hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike.

Sa i përket denoncimeve me nr. 426 ID, 437 ID dhe 443 ID objekt shqyrtimi, nga verifikimi paraprak në fazën e administrimit të denoncimit dhe më pas të shqyrtimit, ndaj postimeve në rrjetin social “Facebook”, të bashkisë Dibër, rezulton se postimi objekt denoncimi me përmbajtje hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral hashtag elektoral sikurse pretendohet nga denoncuesi, nuk gjendet i publikuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se për rastin objekt i denoncimeve të regjistruara me nr. **426 ID, 437 ID, 443 ID**, ndaj bashkisë Dibër, të marra në hetim administrativ, nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Për pasojë vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ ndaj:

- Z. Rakip Suli, Kryetar për bashkinë Kamëz;
- Zj. Floreta Faber, Ambasadore e Shqipërisë në SHBA;
- Z. Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr. 2, Bashkia Tiranë;
- Zj. Emiriana Sako, Kryetare për bashkinë Durrës;
- Z. Ilirjan Engjelli, Administrator i Njesisë Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë;
- Zj. Liri Qoshi, Administratore e Njesisë Administrative nr. 4, Bashkia Tiranë;
- Zj. Alma Dervishi, person përgjegjës për Ministrinë e Shendetesisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Z. Rahim Spahiu, Kryetar dhe kandidat për bashkinë Dibër;

2. T'i tërhiqet vëmendja në mënyrë që të tregohet kujdes në publikimin e postimeve të ndryshme që përmbajnë slogane apo hashtag # me përmbajtje elektorale ndaj personave përgjegjës:
 - Zj. Emiriana Sako, Kryetare për bashkinë Durrës;
 - Z. Ilirjan Engjelli, Administrator i Njesisë Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë;
 - Zj. Liri Qoshi, Administratore e Njesisë Administrative nr. 4, Bashkia Tiranë;
 - Zj. Alma Dervishaj, person përgjegjës për Ministrinë e Shendetesisë dhe Mbrojtjes Sociale.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 26.6.2023

Nr: 677
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 418 ID, 420 ID, 426 ID, 430 ID, 432 ID, 437 ID, 443 ID, 445 ID për shkelje administrative”